

**Gjykatës Themelore në Pejë**  
**Dega në Deçan**  
Departamenti i Përgjithshëm

<b>Paditës</b>	<b>Kelkos Energy Sh.P.K.</b> , me numër unik identifikues 810796005 dhe me adresë në Rr. Deme Ali Pozhari nr. 41, 51000 Deçan, të përfaqësuar nga Avokatët Arianit Koci dhe Granit Vokshi, në vazhdim « <b>Paditësi</b> »
<b>E Paditura</b>	<b>Shpresa Loshaj</b> nga Deçani, e përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika sipas autorizimit të bashkëngjitur, në vazhdim « <b>e Paditura</b> »
<b>Vlera e kontestit</b>	EUR 100,000 (me fjalë: njëqind mijë euro)
<b>Numri i lëndës</b>	C.nr. 380/2020
<b>Data</b>	2 mars 2021

## PËRGJIGJE NË PADI

E Paditura, përmes përfaqësueses së autorizuar ka pranuar më 16 shkurt 2021 Padinë për kompensim të dëmit për shkak të shpifjes të parashtruar në gjykatë më 1 qershor 2020, dhe këtë Përgjigje në Padi e parashtron brenda afatit ligjor dhe në përputhje me Aktvendimin C.nr.380/2020, me numër të lëndës 2020:067979, të datës 12 nëntor 2020 të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega Deçan (në vazhdim «**Gjykata**»). E Paditura e kundërshton kërkesëpadinë e Paditësit përmes kësaj përgjigje në padi sipas argumenteve dhe provave të bashkëngjitura, dhe kërkon nga Gjykata që ta refuzojë padinë si të pabazuar.

### **Baza faktike**

1. E Paditura është rritur në Bjeshkët e Deçanit dhe është hulumtuese e aktiviste për mbrojtjen e mjedisit. Pasi hulumtoi për degradimet ndaj mjedisit në Grykën e Deçanit dhe i vëzhgoi ato nga afër, e Paditura vendosi të themelojë OJQ «Pishtarët» - një organizatë që angazhohet për mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtave të njeriut në Kosovë. E Paditura është njëri ndër zërat më të fuqishëm në Kosovë për mbrojtjen e mjedisit me angazhimin e saj publik dhe ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në vetëdijësimin e publikut duke folur publikisht për shkatërrimin dhe degradimin e mjedisit në Kosovë. E Paditura dhe bashkëaktivistët tjerë mjedisorë arritën që çështjen e mbrojtjes së mjedisit nga degradimi që po shkaktohet nga hidrocentralet ta sjellë në

vëmendje të institucioneve qendrore në Kosovë me ç'rast më 25 shtator 2020 u themelua Komisioni Hetimor Parlamentar mbi procesin e licencimit, operimit, mbikëqyrjes dhe aplikimit për lejet e hidrocentraleve në Republikën e Kosovës. Rëndësia qenësore e aktivizmit të të Paditurës në mbrojtjen e mjedisit dhe informimit të publikut për çështjet mjedisore konfirmohet edhe nga fakti se ajo është ftuar të dëshmojë para Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me dokumentimin dhe gjetjet e organizatës të cilën ajo e drejton «Pishtarët» për çështjet e operimit, licencimit dhe mbikëqyrjes së hidrocentraleve.

2. Më **6 maj 2020**, e Paditura i është drejtuar Ministrit të Mjedisit në Detyrë Z. Lumir Abdixhikut ku i ka listuar shqetësimin dhe gjetjet e organizatës «Pishtarët» lidhur me licencat e përkohshme të lëshuara nga Zyra për Rregullatorin e Energjisë («**ZRRE**») në mungesë të lejes mjedisore, e cila lëshohet nga Ministria e Mjedisit. E Paditura Ministrit i kishte shkruar për licencimin për prodhim të energjisë elektrike për hidrocentralet e Paditësit në Lumbardh të Deçanit dhe për hidrocentralet e kompanisë Hidrogjeni Sh.p.k. në lumin Lepenc të Kaçanikut. Përmes letrës kishte kërkuar takim për t'ia prezantuar ministrit gjetjet dhe shqetësimet e organizatës.

3. Më **8 maj 2020**, e Paditura i është drejtuar ZRRE-së lidhur me licencat e përkohshme që ia kishte lëshuar Paditësit më 14 tetor 2019 për prodhimin e energjisë elektrike për hidrocentralet në Lumbardh të Deçanit, si dhe për licencën e përkohshme të lëshuar më 5 qershor 2019 për hidrocentralet në Lepenc të Kaçanikut për kompaninë Hidrogjeni Sh.p.k. E Paditura në letrën e saj deklaroi se pas një analize rigoroze të organizatës që ajo e drejton si dhe konsultimit me ekspertë ligjorë ka rënë në përfundim se ZRRE ka tejkalluar autoritetin e saj ligjor me lëshimin e këtyre dy licencave meqë, asnjëra kompani (as Paditësi e as Hidregjeni Sh.p.k.) nuk kanë poseduar leje mjedisore, pajisja me të cilën është e domosdoshme për lëshimin e licencës për prodhim të energjisë. Licencat e përkohshme të lëshuara pa sigurim paraprak të lejes mjedisore, e Paditura i ka cilësuar si “licenca fiktive”, meqë pas konsultimit me ekspertë ligjorë dhe pas shqyrtimit rigoroz të procesit të licencimit, e Paditura kishte rënë në përfundim se nuk ka bazë ligjore për lëshimin e licencave të përkohshme në mungesë të paraqitjes së lejes mjedisore.

4. Më **13 maj 2020**, organizata të cilën e drejton e Paditura ka publikuar një video në rrjetin social «Facebook» në të cilën ka deklaruar se Paditësi është duke kontribuar në shkatërrimin e mjedisit dhe natyrës, se nuk ka leje mjedisore dhe e ka kontestuar ligjshmërinë e hidrocentraleve të Paditësit.

5. Më **16 maj 2020** e Paditura ishte ftuar për intervistë në televizionin «KTV» për të biseduar lidhur me punën e saj në mbrojtjen e mjedisit në Kosovë. Mes tjerash, e Paditura ka deklaruar se Paditësi për vite me radhë ka prodhuar energji elektrike pa pasur leje mjedisore dhe që nuk kanë

aplikuar për një kohë të gjatë për leje mjedisore. Në këtë intervistë ajo po ashtu ka folur për dëmin ndaj mjedisit që ka shkaktuar Padiësi me hidrocentralet e tij.

6. Më **1 qershor 2020** Padiësi ka parashtruar padi ndaj të Padiurës duke ngritur disa pretendime për shpifje dhe dëmtim të reputacionit nga deklaratat e të Padiurës në 1) Letrën që ajo ia kishte dërguar më 6 maj 2020 ish-Ministrit të Mjedisit në detyrë Z. Lumir Abdixhiku; 2) Letrën që ajo ia kishte dërguar më 8 maj 2020, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë («**ZRRE-së**»); 3) Një video që ajo e ka shpërndarë më 13 maj 2020 në Rrjetin Social «Facebook» dhe 4) Një deklaratë në televizionin nacional «KTV» të dhënë gjatë një interviste të datës 16 maj 2020. Meqë përmbajtja e deklaratave në shumicën e këtyre rasteve është e njëjtë, në vijim trajtohen pretendimet për shpifje të ndara sipas përmbajtjes së deklarimeve, jo sipas radhitjes kronologjike të deklaratave.

### **Përgjigje ndaj pretendimeve për shpifje dhe analizë ligjore e rrethanave të rastit**

#### **A. Sa i përket pretendimeve për Shpifje**

7. Së pari, është e rëndësishme që Gjykata të konstatojë se deklarata e të Padiurës është deklaratë për çështje me interes publik. Sipas nenit 3, paragrafi k) të Ligjit Nr.02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes («**Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes**»), çështje me interes publik është çdo çështje që është në interes të publikut të publikohet duke përfshirë këtu **çështjet që kanë të bëjnë me ambientin**. Të gjitha deklaratat e të Padiurës që Padiësi i cilëson si shpifje janë deklarata në interes publik për çështjet e mbrojtjes së ambientit dhe gëzojnë mbrojtje brenda lirisë së shprehjes siç është elaboruar më poshtë.

8. Deklaratat e të Padiurës që kanë të bëjnë me operimin e hidrocentraleve pa licencë e pa leje mjedisore si dhe degradimi i mjedisit nga Padiësi, gëzojnë mbrojtje si **deklarata për çështje me interes publik** dhe si **publikime të arsyshme**, në bazë të nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes. Në anën tjetër, deklaratat e të Padiurës lidhur me vlerësimin dhe kontestimin e ligjshmërisë së licencës së përkohshme të lëshuar nga ZRRE, si dhe cilësimin e saj si «licencë fiktive», gëzojnë mbrojtje si **shprehje e opinionit** në bazë të nenit 8 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

*i. Sa i përket pretendimeve për shpifje lidhur me deklaratat e të Padiurës se Padiësi ka prodhuar rrymë pa licencë e pa leje mjedisore për vite me radhë dhe se nuk ka aplikuar me vite për leje mjedisore*

9. Padiësi pretendon se këto deklarime e Padiura i ka bërë pa u mbështetur në **asnjë provë të vetme**. Deklaratat e të Padiurës, Padiësi i konsideron si shpifje sipas nenit 3, pika a) e Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, që përcakton se shpifja është publikimi i një deklaratë të pavërtetë për të cilën publikuesi e ka ditur apo është dashur ta dijë se është e pavërtetë, kuptimi i së cilës e dëmton reputacionin e një personi tjetër.

10. Për ta mbështetur pretendimimet e tij, Paditësi i referohet tri licencave për prodhimin e energjisë të lëshuara nga ZRRE më 14 tetor 2019 për hidrocentralet «Deçani», «Belaje» dhe «Lumbardhi II» dhe bashkëngjet për Gjykatën Aplikacionin për Leje Mjedisore që mban datën 27 shtator 2019. Është e rëndësishme të theksohet që licencave të cilave i'u referohet Paditësi nuk e përfshijnë të gjithë periudhën e punës së Paditësit, si dhe raportimeve për këtë veprimtari. Po ashtu, po këto licenca janë objekt shqyrtimi në aspektin e ligjshmërisë së tyre para Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

11. Paditësi gjatë shtjellimit të pretendimeve të pabazuara në padi i referohet disa dokumenteve e dëshmime tjera të cilat nuk e merr mundin t'i bashkëngjet në padi (Raport i Policisë së Kosovës Njësia kundër krimit mjedisor, Raporte të shumta inspektuese, fotografi, etj.)

12. Asnjë nga pretendimet dhe dokumentet e bashkëngjitura nga Paditësi nuk dëshmojnë se e Paditura ka shpifur. Madje edhe po t'i kishte ofruar Paditësi dëshmitë shtesë të cilave u referohet gjatë argumentimit të padisë por nuk i bashkëngjet në padi, prapë se prapë nuk do të dëshmonin se e Paditura me deklaratat e saj ka shpifur. Arsyeja e vetme pse po e potencojmë se nuk janë bashkëngjitur dëshmitë të cilave padia u referohet është për të demonstruar se sa jo-serioze është qasja e Paditësit në raport me Gjykatën dhe të Paditurën. Sidomos duke pasë parasysh shumën 100,000 euro që e kërkojnë si dëmshpërblim. Pretendimet e Paditësit bashkë me «dëshmitë» e bashkëngjitura në padi janë boshe dhe nuk dëshmojnë asgjë.

13. Deklaratat e të Paditurës lidhur me operimin e hidrocentraleve nga ana e Paditësit pa posedimin e licencës për prodhim të energjisë, dhe pa leje mjedisore mbështeten në fakte dhe gëzojnë mbrojtje si publikime të arsyeshme në interes publik, sipas nenit 5, paragrafi 3 dhe nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

14. Më **14 dhjetor 2016**, ZRRE pas monitorimit të Paditësit, ka konstatuar se Paditësi po operon hidrocentralet «Deçani» dhe «Belaje» në Grykën e Deçanit pa licencë për prodhim të energjisë elektrike dhe pa leje mjedisore. Në këtë Raport, ZRRE konstaton se **Paditësi pa pasur licencë për prodhim të energjisë nga ZRRE, e pa pasur leje mjedisore, ka vazhduar operimin e Hidrocentraleve «Deçani» dhe «Bellaje»**. Ky është konstatimi i ZRRE-së:

«Nga futja në operim e HC Belaje dhe HC Deçan e deri me tash Kelkos ka operuar pa licencë. Fillimisht ky aktivitet është kryer si operim testues, por nga 01 prill 2016 gjeneratorët janë në operim komercial. Në shkurt 2016 Kelkos ka aplikuar për licencë, **por në pamundësi të marrjes së lejes mjedisore** nga MMPH (neni 31 «Leja Mjedisore» i Ligjit për mbrojtjen e mjedisit) **ZRRE nuk i ka lëshuar licencë për**

**operim. Pavarësisht kësaj Kelkos ka vazhduar me operimin e HC Deçani dhe HC Belaje, pa licencë.»<sup>1</sup>**

15. Dy vite më vonë, në Raportin **vjetor 2018**, ZRRE konstaton sërish se Paditësi nga data 1 prill 2016 ka vazhduar operimin komercial , pa pasur licencë për prodhim të energjisë dhe pa pasur leje mjedisore. Arsyeja pse ZRRE nuk i ka dhënë licencë për prodhim të energjisë elektrike Paditësit është se nuk ka pasur leje mjedisore.

16. Sa i përket pretendimit se e Paditura ka shpifur kur ka deklaruar se Paditësi nuk ka pasur leje mjedisore, në njërën anë Paditësi e cilëson si shpifje deklaratën e të Paditurës se Paditësi nuk posedon Leje Mjedisore (shih Padinë për shpifje, paragrafi 1.5.), ndërsa në anën tjetër bie në kundërshtim me veten duke e pranuar se nuk posedon Leje Mjedisore (shih Padinë për shpifje, paragrafi 1.15.).

17. Sipas nenit 5, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes personat mund të japin përgjegjësi për shpifje për çështje të interesit publik **vetëm** në qoftë se autori e ka ditur se informacioni ka qenë i rrejtshëm ose ka vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e tij. Në rastin konkret, deklaratimet e të Paditurës lidhur me operimin të hidrocentraleve të Paditësit pa licencë dhe pa leje mjedisore mbështeten në informata publike zyrtare të publikuara nga ZRRE që janë përpiluar posaçërisht për hidrocentralet me të cilat operon Paditësi në Grykën e Deçanit. Rrjedhimisht, deklaratimet e të Paditurës gëzojnë mbrojtje si deklarata të mbështetura në fakte pasi që bazohen në raporte zyrtare të ZRRE-së sipas nenit 5, paragrafi 3 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes.

18. Përpos kësaj, deklaratimet e të Paditurës për operimin e paditësit pa licencë e pa leje mjedisore gëzojnë mbrojtje si publikime të arsyeshme për çështje me interes publik. Sipas nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcaktohet se askush nuk do të mbajë përgjegjësi për shpifje për deklarata lidhur me çështje me interes publik, kur është e arsyeshme në të gjitha rrethanat që një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë për informimin e publikut në kohë. Siç u përmend, e Paditura është aktiviste që angazhohet për mbrojtjen e mjedisit dhe deklaratimet e saj (të mbështetura në raportet e ZRRE-së) lidhur me operimin pa licencë të hidrocentraleve nga ana e Paditësit i ka shprehur në një intervistë të dhënë për televizionin nacional «KTV». Ajo ka shfrytëzuar platformën publike që i është dhënë për të ngritur publikisht shqetësimet për shkeljet ligjore që po i bëjnë kompanitë e hidrocentraleve në Kosovë. Prandaj, deklarimi i saj ka qenë publikim i arsyeshëm sipas nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes,

---

<sup>1</sup> Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport nga monitorimi i ndërmarrjes «Kelkos Energy» Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqe 17-18.

meqë deklaratat lidhur me mbrojtjen e mjedisit nga keqpërdorimet kanë ndjekur një qëllim të mirë për njoftimin e publikut në kohë për një çështje të interesit publik.

19. Deklaratat e të Paditurës, si deklarime faktike gëzojnë mbrojtje edhe sipas standardeve të vendosura nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut («GjEDNj»), praktika e së cilës mbizotëron në të drejtën tonë vendore sipas nenit 53 të Kushtetutës. GjEDNj si parim themelor rikujton çdo herë në vendimet e saj në këtë fushë që liria e shprehjes është një ndër themelet më esencial të një shoqërie demokratike dhe paraqet kusht thelbësor për zhvillimin e saj si dhe për vetëpërmbushjen individuale. Mbrojtje me lirinë e shprehjes gëzojnë jo vetëm «informatat» dhe «idetë» që pranohen lehtësisht apo me indiferencë nga të tjerët, por edhe ato që shokojnë, shqetësojnë dhe ofendojnë. Këtë e kushtëzojnë kërkesat për pluralizëm, mendjegjerësi e tolerancë pa të cilat nuk mund të ketë shoqëri demokratike. Në rastin *Tromso dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, një gazetë në Tromso të Norvegjisë publikoi në artikull në të cilin i referohej gjetjeve të një raporti zyrtar të inspektimit, që ishte porositur nga Ministria e Peshkatarisë. GjEDNj kishte vendosur se gazetaret që publikojnë shkrime për çështje në interes publik nuk janë të obliguar që t'i vërtetojnë vetë përmes hulumtimit të pavarur pohimet e përmbajtjeve të raporteve zyrtare.<sup>2</sup> Përndryshe, do të minohej roli vital i mediave si mbikëqyrës publik. GjEDNj ka pranuar se organizatat e shoqërisë civile që tërheqin vëmendjen në çështje të interesit publik e ushtrojnë po ashtu rolin e mbikëqyrësit publik, rol i ngjashëm me rëndësinë e mediave, që u jep mbrojtje të ngjashme me atë që u takon mediave.<sup>3</sup> Edhe në rastin tonë, e Paditura deklaroi se Paditësi nuk ka pasur leje mjedisore dhe ka prodhuar rrymë me vite pa licencë, i ka mbështetur në raportet e ZRRE-së, që janë raporte zyrtare të një institucioni shtetëror. Prandaj, nuk mund të pritet nga e Paditura që t'i vërtetojë vet të gjeturat e ZRRE-së sepse raportet zyrtare për shkak të natyrës së tyre cilësohen si të besueshme.

20. Përfundimisht, e Paditura ka ushtruar të drejtën e saj fundamentale të lirisë së shprehjes, shprehjes të garantuar me nenin 40 të Kushtetutës, kur ka deklaruar publikisht se Paditësi ka operuar për vite pa licencë dhe pa leje mjedisore dhe këto deklarata i ka mbështetur në fakte. Prandaj e Paditura nuk bartë përgjegjësi për shpifje dhe pretendimet e Paditësit duhet të refuzohen nga kjo Gjykatë si të pabazuara.

**Prova nr.1.1:** Zyra e Rregullatorit për Energji,  
*Raport nga monitorimi i ndërmarrjes «Kelkos Energy»*  
*Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqe 17-18.

<sup>2</sup> GjEDNj, *Bladet Tromso dhe Stensaas kundër Norvegjisë*, 21980/93, 20 maj 1999, para.68.

<sup>3</sup> GjEDNj, *Animal Defenders International v. the United Kingdom* [Dhoma e Madhe], 2013, 48876/08, para. 103.

**Prova nr.1.2:** Zyra e Rregullatorit për Energi,  
*Raport vjetor 2018*, mars 2019, faqe 18.

ii. *Sa i përket pretendimeve për shpifje lidhur me deklaratat e të Paditurës se Paditësi ka kontribuar në degradimin e mjedisit në Grykën e Deçanit*

21. Paditësi pretendon se nuk e ka dëmtuar e degraduar mjedisin dhe i cilëson si shpifëse deklaratimet e të Paditurës se Paditësi ka kontribuar në degradimin e mjedisit në Grykën e Deçanit. Për ta mbështetur këtë pretendim Paditësi përmendë procesverbale «të shumta» inspektuese dhe fotografi që sipas tij dëshmojnë që rehabilitimi natyral është kompletuar «në nivel të kënaqshëm». Sidoqoftë, nuk ofron asnjë procesverbal dhe asnjë fotografi për ta mbështetur këtë pretendim. Paditësi deklaron se mos-degradimi i mjedisit nga ana e tij është konfirmuar nga Njësia kundër krimit mjedisor të Policisë së Kosovës. As këtë dokument Paditësi nuk e bashkëngjet si provë. Më tej, Paditësi deklaron se nuk është përgjegjës për dëmet e shkaktuara në zonën «Zalli i Rupës» pasi që zallin në këtë zonë e ka gërmuar dhe e ka shfrytëzuar kompania Lika Sh.p.k. që po e bën ndërtimin e rrugës Deçan-Plavë. Dhe në fund, sipas Paditësit institucionet shtetërore të Kosovës **«nuk kanë gjetur ndonjë vërejtje negative në rehabilitimin dhe operimin e kompanisë Kelkos»**. Paditësi përmes këtyre deklaratave përpiqet ta vë në lajthitje Gjykatën meqë, në fakt ka shumë raporte nga institucionet shtetërore të Kosovës që kanë gjetur jo vetëm vërejtje negative në rehabilitim dhe operim të kompanisë Kelkos por, kanë konstatuar degradimin e mjedisit nga kjo kompani. Vlen të theksohet se edhe po të mos kishte pasur asnjë raport institucional që i dëshmon shkeljet ligjore të Paditësit, kjo nuk do të pengonte në asnjë mënyrë të Paditurën që në bazë të angazhimit të saj qytetar të bëjë hulumtime dhe të dalë me përfundime në bazë të gjetjeve të saj lidhur me aktivitetet e Paditësit në Grykën e Deçanit.

22. Më **20 dhjetor 2013** dhe më **28 prill 2014**, Kompania e Ujësjellësit Rajonal Sh.A. Hidrodrini, i është drejtuar me një Njoftim dhe kërkesa zyrtare Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë, Njesisë për Monitorimin e ndërmarrjeve Publike në Kuvendin Komunal - Deçan. Përmes këtyre shkresave Hidrodrini kishte kërkuar që të inspektohen punimet e Paditësit meqë i ishin afruar shumë burimeve të ujit të pijshëm, që bën furnizimin me ujë të afro 37,000 banorëve të Deçanit nga 6 burime kryesore. Punimet për ndërtimin e hidrocentraleve ishin zhvilluar pa u njoftuar dhe pa u koordinuar me Hidrodrinin. Në njoftim, Hidrodrini kishte ngritur shqetësimin se Paditësi po planifikon të bëjë dislokimin e tubacionit që bën furnizimin me ujë të pijshëm për banorët e Deçanit pa kurrëfarë analize dhe aprovim nga Hidrodrini.

**Prova nr. 2.1:** Hidrodrini, *Njoftim*, 24 dhjetor 2013

**Prova nr. 2.1:** Hidrodrini, *Njoftim*, 28 prill 2014

23. Më **5 maj 2014**, për shkak të pranimit të njoftimeve nga Hidrodrini, Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Departamenti i Ujërave, kishte zhvilluar një inspektim për ndërhyrjen eventuale të zhvillimit të punimeve të hidrocentraleve në Grykën e Deçanit me burimet e furnizimit publik me ujë të pijes. Inspektorati ka përgatitur një Raport për inspektimin e Grykës së Deçanit dhe ka konstatuar si vijon:

«Nga vizita ne terren konstatojmë se **ka humbur një burim i ujitë të pijës** me kapacitet 8 l/s(tetë litra në sekond), **është dislokuar gypi Ø 200 mm që furnizon me ujë banorët e KK Deçanit**, është hedhe shumë material nga gërmimi i kanalit për vendosjen e gypave ne pjesen e poshtme të rruges nga bregu i lumit, është dëmtuar rrethoja e kaptazhës kryesore prej nga fillon furnizimi me ujë me gyp Ø 315 mm, qe është arteria kryesore e furnizimit. Mbi kanal të gypit Ø 315 mm është hedhur sasi e madhe e materialit nga gërmimi i kanalit për dislokimin e gypit Ø 200 mm, është ngushtuar shtrati i lumit nga materiali i hedhur në bregun e tij, si dhe është bërë degradimi jashtëzakonisht i madhe në ambient nga eksploatimin e zhavorrit dhe rërës ne vendi e ashtuquajtur “ZALLI I RUPËS” – pa asnjë dokument nga MMPH-ja, KK Deçan dhe pa asnjë kriter.»

**Prova nr.3:** Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Departamenti i Ujërave, *Inspektim në bazë të ankesës së Hidrodrinit rreth ndërtimin e HEC- ve, Deçan, 5 maj 2014.*

24. Më **25 shkurt 2019**, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës («**AMMK**») i është drejtuar me shkresë zyrtare të titulluar «Hidrocentralet në Parqet Kombëtare, rrezik për biodiversitetin», Z. Fatmir Matoshi - Ministrit të atëherëshëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Sekretarit të atëherëshëm të kësaj ministrie, Z. Arben Çitaku. Në këtë shkresë AMMK i numëron disa nga dëmet më të mëdha në mjedis që shkaktohen nga ndërtimi dhe operimi i hidrocentraleve, po i përmendim vetëm disa: (1) ndryshimi i lagështisë së ajrit dhe mikroklimës si pasojë e devijimi i ujit nga rrjedha natyrore që rrezikon drejtëpërdrejtë shumë lloje shtazore ujore, si peshq, insekte të ujit, molusqe, flutura, si dhe bimët që gjenden përreth shtratit të lumit; (2) rreziku i rrëshqitjeve masive të pjesëve shkëmbore të maleve përgjatë luginës së lumenjëve; (3) rrezikimi i pyjeve halore për shkak të mungesës së lagështisë së ajrit, etj. Pastaj AMMK e njofton Ministrinë si vijon:

«Një shembull i tillë i shkatërrimit të këtyre vlerave natyrore është funksionimi i hidrocentralit në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, konkretisht në Grykën e Deçanit, **ku është degraduar shtrati burimor i lumit dhe mund të thuhet se është shkatërruar e gjithë fauna që lidhet më rrjedhjen e Lumëbardhit të Deçanit.**



Përgjatë luginës së rrjedhave lumore të përshtatshme për ndërtim të hidrocentraleve gjenden shumë lloje të vegetacionit të rralla e të rrezikuara siç janë: *Pinus peuce*, [i përmendë 20 emra të llojeve të vegetacionit në latinisht].»

**Prova nr. 4:** Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Hidrocentralet në Parqet Kombëtare, rrezik për biodiversitetin*, 25 shkurt 2019.

25. AMMK në vitin 2019 ka publikuar Raportin për Gjendjen e Natyrës për vitet 2015-2017. Në këtë raport AMMK e konstaton sërish shkatërrimin e vlerave natyrore nga funksionimi i hidrocentraleve në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” në Grykën e Deçanit dhe më tutje thekson:

«Nga ndërtimi i hidrocentraleve në Grykën e Deçanit janë konstatuar ndërhyrje të konsiderueshme përgjatë aksit rrugor dhe shtratin e lumit ku kompania është duke vazhduar me implementimin e projektit.

Ndërhyrjet me dëmtrim të vlerave natyrore janë shkaktuar me rastin:

- zgjerimit të aksit rrugor, me që rast me prerjen e pjesëve anësore të rrugës në shumë vende ka ardhur deri te procesi i rrëshqitjeve të masave që kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme (panevojshme);
- hapjes së kanalit për vendosjen e gypave, ndërhyrje janë realizuar në brigjet e lumit dhe vet shtratin e tij;
- shfrytëzimit pa asnjë kriter të zhavorrit të Zalli i Rupës, ku janë degraduar sipërfaqe të konsiderueshme;
- si pasoje e shfrytëzimit të ujit nga hidrocentrali ka ardhur deri te zvogëlimi i sasisë së ujit në lumbardhën e Deçanit dhe shkatërrimin e biodiversitetit të lumit.»

**Prova nr. 5:** Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Raportin për Gjendjen e Natyrës për vitet 2015-2017*, publikuar në vitin 2019.

26. Përpos raporteve të institucioneve shtetërore, e Paditura ka përcjellë dhjetra artikuj të publikuar nga mediat në Kosovë që kanë raportuar për protestat e banorëve të Deçanit dhe organizatave të shoqërisë civile kundër hidrocentraleve të Paditësit si dhe për dëmet që i janë shkaktuar Grykës së Deçanit nga aktiviteti i Paditësit. Ajo po ashtu ka shkruar edhe vetë në Grykën

e Deçanit dhe i ka vëzhguar dëmet që i janë bërë Grykës së Deçanit nga puna me hidrocentrale. Këtu po i bashkëngjesim vetëm disa nga to:

**Prova nr.6:**

- Foto nga Pishtarët dhe burime tjera
- Kallxo.com, [Vuajtja e Grykës së Deçanit nga hidrocentralet](#), 13 shtator 2018.
- Koha.net, [Katër hidrocentrale si ato që po synohen në Lumbardh kanë shkatërruar Grykën e Deçanit](#), 25 shkurt 2019, <https://www.koha.net/arberi/147139/kater-hidrocentrale-si-ato-qe-po-synohen-ne-lumbardh-kane-shkaterruar-gryken-e-decanit/>
- RTKlive.com, [MMPH-ja dhe shoqëria civile kundër vendimit për tri hidrocentralet në Deçan](#), 15 tetor 2019
- RTV21.tv, Protestuesit ‘pushtojnë’ grykën e Deçanit kundër hidrocentraleve pa leje, 13 korrik 2019
- Kosovalive.org, Ndërtimi i hidrocentraleve të Deçanit po e lë pa ujë shtratin e Lumëbardhit, 29 qershor 2016
- Klan Kosova TV, [Hidrocentrali në Deçan thanë Zonën](#), 10 prill 2016.

27. Përpos raportimeve në media, Paditësi është kritikuar për dëmtimin e ambientit në Lumbardhin e Deçanit edhe nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile. Njëri nga to është Raporti i organizatave Balkan Green Foundation dhe INDEP, i publikuar në mars 2019 me titull «Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe Potenciali i Tyre Real», ku theksohet:

**«Investimet e fundit që kanë ndodhur në luginën e Lumbardhit të Deçanit nga kompania austriake Kelkos Energy kanë rezultuar me probleme të shumta mjedisore, me projekte gjysmake dhe të dështuara që i kanë vënë hije të keqe investimeve në sektorin e hidroenergjisë. Ky rast ka shtyrë Komunën e Deçanit të ndërmerrë edhe hapa ligjor me kërcënim për të ngritur padi ndaj kompanisë në fjalë si dhe ndaj vetë MMPH-së për mos-respektim të minimumit biologjik.**

**Ndër hapësirat dhe bjeshkët më të bukura në Kosovë janë në rrezik të shkatërrimit të pakthyeshem nga ndërhyrja brutale me qëllim të prodhimit të energjisë elektrike nga uji, në kuadër të shtimit të nivelit të energjisë së ripërtëritshme. “Banorë të qytetit të Deçanit janë alarmuar nga rritja shumë e shpejtë e projekteve zhvillimore që rrezikojnë lumenjtë**

dhe bjeshkët nga degradimi ambiental por dhe që kanë efekt direkt në jetën e popullatës atje.”

Kështu, Komuna e Deçanit por edhe ajo e Pejës, kanë marrë qëndrim që të ndalojnë kategorikisht ndërtimet e reja të hidrocentraleve në Lumbardhin e Deçanit e atë të Pejës, **ku këto projekte shihen si degradim i natyrës dhe që pengojnë dukshëm zhvillimin e turizmit dhe biejnë ndesh me planet dhe projektet komunale të zhvillimit e kanë ndikim negativ në turizëm.** Prej këtyre projekteve po përfitojnë kryesisht grupe të caktuara të interesit e jo Deçanasit apo qytetarët e Pejës dhe prandaj kanë vendosur që të mos lëshojnë leje ndërtimi për HCV apo të mëdha në ato hapësira, pavarësisht se institucionet tjera të nivelit qendror u kanë dhënë leje.»<sup>4</sup>

28. Më tej, në përfundimet e këtij raporti theksohet:

«Mungojnë mekanizmat efektiv të monitorimit të zbatimit të projekteve. Zyra e Rregullatorit për Energji, Inspektorati i Mjedisit dhe mekanizmat e tjerë kanë dështuar të sigurojnë se projektet respektojnë standardet mjedisore dhe obligimet ligjore që kanë. Në mungesë të mekanizmave mbikëqyrës, **kompanitë në shumë raste kanë abuzuar me licencat dhe nuk kanë respektuar kushtet e kontratave.** Kjo mungesë e inspektimeve dhe ndëshkimeve **ka rezultuar me zona të dëmtuara dhe aktivitete të paligjshme e rrjedhimisht kjo është shoqëruar edhe me probleme sociale.»<sup>5</sup>**

**Prova nr.7:** INDEP, Balkan Green Foundation, *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqet 1-3, 18-20 dhe 24.

29. Deklaratat e të Paditurës lidhur me dëmin ndaj mjedisit që Paditësi ka shkaktuar me ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve bazohen në: (1) Raporte e shkresa të ndryshme të institucioneve shtetërore të Kosovës të radhitura këtu nga Prova nr.1 deri në Provën nr.5, që e

---

<sup>4</sup> INDEP, Balkan Green Foundation, *Hidrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqe 18-20, i qasshëm në vegzën: <https://indep.info/wp-content/uploads/2019/03/HIDROCENTRALET-NE-KOSOVE-PROBLEMET-DHE-POTENCIALI-I-TY-RE-REAL-BGF-INDEP.pdf>.

<sup>5</sup> Po aty, faqe 24.

thonë po këtë gjë - që Paditësi e ka degraduar mjedisin me aktivitetet e tij; (2) Vëzhgimi i vendit ku ndodhen hidrocentralet nga e Paditura; (3) Raportimet në media të shkruara e vizuale të Kosovës për degradimin e mjedisit nga Paditësi në Grykën e Deçanit, të bashkëngjitura këtu si Prova nr.6, si dhe (4) Raportime nga organizatat tjera të shoqërisë civile që po ashtu kanë zhvilluar hulumtime dhe kanë dokumentuar degradimin e mjedisit në Grykën e Deçanit për shkak të hidrocentraleve të Paditësit, të bashkëngjitura si Prova nr.7.

30. Rrjedhimisht, deklarata e të Paditurës lidhur me degradimin e mjedisit nga Paditësi është e bazuar në fakte dhe gëzon mbrojtje në kuadër të së drejtës së lirisë së shprehjes, që mbrohet me nenin 40 të Kushtetutës së Kosovës. Përkatesisht, sipas nenit 5, paragrafi 3 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes e Paditura do të mbante përgjegjësi vetëm po që se do të kishte vepruar me mospërfillje të pamatur për vërtetësinë e deklaratës. Në rastin konkret, e Paditura ka hulumtuar dhe ka mbledhur informata nga burime të ndryshme institucionale, të mediave e të organizatave jo-qeveritare, dhe duke u mbështetur në to ka deklaruar publikisht se Paditësi me hidrocentrale ka degraduar mjedisin në Grykën e Deçanit. Deklaratat e të Paditurës janë deklarata për çështje me interes publik të cilat e Paditura i ka bërë duke u bazuar në burime të ndryshme të informacionit dhe janë të mbrojtura me lirinë e shprehjes.

31. Po ashtu, deklaratat e të Paditurës lidhur me degradimin e mjedisit nga Paditësi janë deklarata që mbrohen edhe në bazë të nenit 7 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes meqë, janë publikime të arsyeshme e të pritshme nga një person si e Paditura në rrethanat dhe pozitën e saj të aktivistes për mbrojtjen e mjedisit, dhe janë deklarata që për qëllim kanë informimin e publikut lidhur me rrezikun dhe dëmet që po i shkaktohen mjedisit.

*iii. Sa i përket pretendimeve për shpifje lidhur me deklaratën e të Paditurës se i konsideron të kundërligjshme aktivitetet e Paditësit në Grykën e Deçanit;*

32. Paditësi pretendon se e Paditura ka shpifur kur i është drejtuar me letër ZRRE-së dhe Ministrit të atëhershëm të Mjedisit Z. Lumir Abdixhiku, me ç'rast i ka sqaruar arsyet se pse ajo vlerëson që licenca e përkohshme e lëshuar ndaj Kelkos është në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji Elektrike si dhe Rregulloren për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë. E Paditura këtë licencë të përkohshme e ka cilësuar si «licencë fiktive» meqë nuk gjen mbështetje në dispozitat që e rregullojnë procesin e marrjes së licencës për prodhim të energjisë elektrike. Për Paditësin, cilësimi i licencës nga e Paditura si «licencë fiktive» është cilësim i pavërtetë, i mbështetur vetëm në «vlerësimin personal të të Paditurës» dhe se i ka shkaktuar dëm Paditësit. Paditësi nuk ofron as edhe një dëshmi të vetme për dëmin e pretenduar.

33. Nëse e përcjellim logjikën e argumentimit të Paditësit, i bie se **askush** nuk mund të japë mendime e vlerësime për ligjshmërinë apo joligjshmërinë e vendimeve të institucioneve shtetërore dhe po ashtu, nuk bën që qytetarët t'i ngrisin shqetësimet e tyre lidhur me ligjshmërinë e vendimeve në institucionet që i kanë nxjerrur ato vendime. Gjithnjë sipas logjikë së argumentimit të Paditësit, e Paditura **nuk** është dashur që shqetësimet e saj lidhur me ligjshmërinë e licencës së ZRRE-së t'ia drejtojë vetë institucionit që e ka nxjerrë atë vendim dhe nuk është dashur t'i shkruaj zyrtarisht Ministrisë së Mjedisit, leja mjedisore e së cilës është parakusht për lëshimin e licencës së ZRRE-së. Paraqitja e këtij argumenti është absurde në një shtet demokratik që i mbron të drejtat dhe liritë e njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën në ankesë dhe lirinë e shprehjes. Ndoshta kjo linjë e të argumentuarit do kishte funksionuar në shoqëri totalitare e autoritare ku personat që i kritikojnë vendimet e institucioneve shtetërore burgosen, torturohen e vriten. Megjithatë, Kosova si shtet demokratik është ndërtuar mbi vlera të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë këtu të menduarit ndryshe, pluralizmin, kritikën dhe mendimet që nuk pranohen lehtësisht nga të gjithë.

34. E Paditura, ashtu siç e ka njoftuar edhe Ministrin e atëhershëm Z. Lumir Abdixhiku dhe ZRRE-në, ka bërë një analizë rigorozë të procesit të lëshimit të licencave për prodhim të energjisë elektrike gjatë vitit 2019 nga ZRRE. E përpos kësaj, e Paditura është këshilluar edhe me ekspertë ligjorë për të qenë e sigurtë se leximi i saj i ligjit është i drejtë. Kështu, **më 29 prill 2020** e Paditura e kishte kontaktuar gazetaren Znj. Jeta Xharra, Drejtoreshë Ekzekutive e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese («**BIRN**») dhe ka kërkuar nga Znj. Xharra që Departamenti Ligjor i BIRN ta konfirmojë për të nëse leximi i dispozitave ligjore nga ana e saj është i saktë. Pra, që ta konfirmojnë se ZRRE sipas nenit 5, paragrafit 6 të Rregullores për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë Elektrike në Kosovë, licencë të përkohshme mund të lëshojë vetëm në rast të mungesës së paraqitjes së evidencës për «efikasitetin termik», dhe jo edhe në mungesë të paraqitjes së lejes mjedisore. Sipas interpretimit ligjor të të Paditurës nuk mund të prodhosh energji elektrike nëse nuk je pajisur me leje mjedisore, dhe asnjë kriter tjetër ligjor nuk e zëvendëson lejen mjedisore.

35. Më **30 prill 2020**, Z. Kastriot Berisha, Zyrtar Ligjor nga BIRN ia ka konfirmuar me shkrim të Paditurës se interpretimi i saj është i saktë dhe e konfirmon se «kompania për tu licencuar duhet ta ketë lejen mjedisore, nëse është e aplikueshme». Pas këtij konfirmimi, e Paditura ka shkruar dy letrat për të cilat Paditësi ka parashtruar padi dhe licencat e përkohshme në mungesë të lejes mjedisore i ka quajtur «licenca fiktive», meqë nuk gjejnë mbështetje në rregullat që e rregullojnë procesin e fitimit të licencës për prodhim të energjisë elektrike.

**Prova nr.8:** Korrespondenca në mes të Shpresa Loshajt, gazetares Jeta Xharra dhe Kastriot

36. Deklaratat e të Paditurës lidhur me cilësimin e licencave të përkohshme të ZRRE-së për Paditësin si «licenca fiktive» janë deklarime të opinionit. Përkatësisht sipas nenit 8 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes përcaktohet se «*Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të cilën gjykata e ka vlerësuar të jetë një deklaram i opinionit, me kusht që opinionit të jetë shprehur me qëllim të mirë dhe të jetë bazuar në ndonjë fakt*».

37. Në praktikën e saj, GjEDNj e bën dallimin në mes të deklarimeve faktike dhe vlerësimeve gjyquese apo opinioneve.<sup>6</sup> Përderisa ekzistimi i fakteve mund të demonstrohet, e vërteta e vlerësimeve gjyquese apo opinioneve nuk mund t'i nënshtrohet procesit të provuarit.<sup>7</sup> Sipas GjEDNj-së t'i kërkosh dikujt ta provojë të vërtetën prapa opinionit të vet është kërkesë e pamundur dhe e cënon lirinë e mendimit më vete, që mbrohet me lirinë e shprehjes.<sup>8</sup> Në raste të vlerësimit se a janë opinionet e shprehura të mbrojtura me lirinë e shprehjes GjEDNj vlerëson nëse opinionit i shprehur «ka bazë të mjaftueshme faktike». Në vendimin për rastin *G.R.A. Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës* («G.R.A.»), GjEDNj ka vendosur se gjykatat vendore zvicerane e kanë shkelur të drejtën e kësaj organizatës G.R.A. në liri të shprehjes pasi që i kanë dalë në mbrojtje të reputacionit një politikani të ri i cili e kishte mbrojtur në një fjalim iniciativën për ndalimin e ndërtimit të minareve në Zvicër.<sup>9</sup> Organizata G.R.A. e kishte cilësuar një deklaram të këtij politikani si «racizëm verbal» ndërkaq, gjykatat në Zvicër kishin vlerësuar se ky publikim e ka dëmtuar reputacionin e tij dhe e kishin urdhëruar organizatën ta largojë deklaramen.<sup>10</sup> GjEDNj ka vendosur se gjykatat vendore në Zvicër padrejtësisht ia kanë cënuar të lirinë e shprehjes organizatës G.R.A. dhe për këtë vendim ka marrë parasysh se përshkrimi i qëndrimeve të politikanit si «**racizëm verbal**», gjente mbështetje në raportimet e ndryshme të organizatave të shoqërisë civile që kishin raportuar për çështjen e iniciativës për ndalimin e ndërtimit të minareve në Zvicër.

38. Në rastin konkret, e Paditura e ka cilësuar si fiktive licencën e përkohshme të lëshuar nga ZRRE dhe këtë e ka bazuar në leximin e saj të ligjit dhe në konfirmimin nga Departamenti Ligjor i BIRN. Në mungesë të lejes mjedisore dhe të plotësimit të kriterëve ligjore për marrjen e licencës për prodhim të energjisë elektrike, dhënia e një «licence të përkohshme» është vlerësuar nga e

---

<sup>6</sup>GjEDNj, *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018, paragrafi 68 dhe referencat në të.

<sup>7</sup>Po aty.

<sup>8</sup>Po aty.

<sup>9</sup>GjEDNj, *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GJEDNJ, 9 janar 2018.

<sup>10</sup>Po aty.

Paditura si licencë e shpikur apo fiktive. Rrjedhimisht, deklarata e të Paditurës se licenca e përkohshme ZRRE-së, në mungesë të lejes mjedisore është «licencë fiktive» është shprehje e opinionit e bazuar në bazë faktike të mjaftueshme të cilën nuk është e detyruar ta demonstrojë a ta provojë para Gjykatës. Si e tillë kjo deklaratë është e mbrojtur me nenin 8 të Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes dhe nenit 40 të Kushtetutës së Kosovës.

39. Në fund duhet përmendur se është krejt e pakuptimtë që Paditësi të ngrisë pretendime për shpifje kur në fakt kritika e shprehur me opinionin e të Paditurës i është drejtuar ZRRE-së, sepse ZRRE i ka nxjerrë këto licenca të cilat e Paditura i konsideron fiktive, e jo Paditësi.

40. Shqetësimi i Paditësit lidhur me kontestimin e vendimeve si të paligjshme nga ana e të Paditurës, nuk do të elaborohet më tej meqë ky shqetësim është i pavend në një sistem demokratik ku secili e ka të drejtën në ankesë, dhe administrata publike është e hapur dhe funksionon në të mirë të publikut.

#### **B. Sa i përket pretendimeve për dëmtim të reputacionit**

41. Paditësi pretendon se deklaratat e të Paditurës i kanë shkaktuar dëm reputacionit të tij dhe këtë pretendim përpiqet ta argumentojë duke thënë se paditësi është «ndërmarrje e respektuar në shoqërinë Kosovare», se «ka emër dhe reputacion të shkëlqyer», dhe se është «kompani e suksesshme dhe **respektuese e ligjit në Republikën e Kosovës**». Më tej, Paditësi thekson se është kompani me profil të lartë lidhur ngushtë me kompaninë amë Kelag dhe se dëmi real vështirë se do të mund të kompensohej. Asnjë nga këto të thëna nuk dëshmojnë asgjë dhe çka është më e rëndësishme, nuk e mbështesin fare pretendimin e Paditësit se e Paditura me deklaratat e saj i paskësh shaktuar dëm. Paditësi nuk ka ofruar as edhe një provë të vetme për të dëshmuar ose për të dokumentuar dëmin që pretendon t'i jetë bërë me deklaratat e të Paditurës. Për më shumë, të gjitha deklaratat e të Paditurës janë deklarata që mbrohen nga Ligji kundër Shpifjes dhe Fyerjes prandaj nuk mund të pretendohet shkaktimi i dëmit nga to, prej vet faktit se nuk konsistojnë shpifje.

42. Rikujtojmë se Paditësi, që është kompani multimilionshe (sipas Padiisë për shpifje ndaj të Paditurës, paragrafi 1.1.) dhe po kërkon dëmshpërblim 100,000 euro nga një aktiviste mjedisore për shkak të deklaratave të saj për mbrojtjen e mjedisit. Kjo shumë marramendëse që po kërkohet me padi, së bashku me mungesën e plotë të dëshmive për të mbështetur pretendet për shpifje dhe dëmin e supozuar, janë tregues të qartë se qëllimi i Paditësit është që përmes kësaj padie të frenohet kritika ndaj aktiviteteve të tij.

43. Këtë padi e cilësojmë si padi SLAPP (Strategic Lawsuits Against Public Participation) – Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike. Kështu i thonë ndërkombëtarisht padive që parashtrihen nga kompani me kapital të madh, të cilat *prima facie* vërehen se janë padi të pabazuara

në fakte dhe qëllimi i tyre i vetëm është që të frikësojnë dhe të dekurajojnë gazetarët apo aktivistët nga raportimi ose diskutimi i mëtejme i çështjeve me interes publik, duke i futur në procese të kushtueshme gjyqësore. Dëmet ndaj ambientit dhe llogaridhënia e kompanive për shkaktimin e tyre janë çështje me interes publik prandaj debati publik lidhur me këtë çështje nuk bën të frenohet e dekurajohet me miratimin e padive SLAPP.

44. Kjo nuk është padia e parë e kësaj natyre që Paditësi parashtrohet. Ngjashëm me këtë padi, Paditësi më 30 janar 2020 ka kërkuar dëmshpërblim 10,000 euro për kinse dëmtimin e reputacionit të tij të mirë nga aktivisti mjedisor Adriatik Gacaferi. Dëmshpërblimin 10,000 euro Paditësi e kishte kërkuar për shkak të një postimi në Facebook përmes së cilës ky aktivist kishte ngritur shqetësimet e tij publikisht për dëmet që po i shkaktohen Lumbardhit të Deçanit. Dëmshpërblimit të kërkuar nga e Paditura Paditësi ia ka shtuar edhe një zero, pra nga 10,000 euro në 100,000 euro për arsye të panjohura dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi për dëmin apo për këtë shumë.

45. Është e qartë se miratimi i padive SLAPP të Paditësit do të çonte mesazh frenues, dekurajues dhe kufizues të aktivistët tjerë që angazhohen për këto çështje dhe do të pengonte pjesëmarrjen aktive të tyre në debatin publik për mbrojtjen e mjedisit. Gjatë vlerësimit të çështjes se a do të duhej të kufizohet liria e shprehjes për t'ia mbrojtur e reputacionin dikujt, GjEDNJ vlerëson se a janë balansuar drejt dy vlera të garantuara me Konventë: e drejta në privatësi, që përfshin edhe mbrojtjen e reputacionit, me të drejtën e lirisë së shprehjes.<sup>11</sup> Në këtë rast, GjEDNJ vlerëson edhe natyrën dhe ashpërsinë e sanksionit të imponuar mbi palën që pretendon shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes kur e shqyrton se a ka qenë kufizimi i lirisë së shprehjes/ndërrhyrja e shtetit proporcionale.<sup>12</sup> GjEDNJ vë rendësi të posaçme në atë se a do të shkaktonte sanksioni një «efekt frenues» («chilling effect») ndaj lirisë së shprehjes së palës, ashtu që e dekurajon atë nga ndjekja e rasteve të kritikës së ngjashme ndaj proceseve publike.<sup>13</sup> Në rastin tonë i bie se Gjykata duhet të vlerësojë nëse miratimi i padisë për shpifje ndaj të Paditurës do të shkaktonte efekt frenues ndaj lirisë së shprehjes së saj apo të tjerëve që dëshirojnë t'i kritikojnë hidrocentralet apo akterët tjerë që e dëmtojnë mjedisin.

46. Për të gjitha arsyet e përmendura, kjo padi duhet të refuzohet si e pabazuar nga Gjykata. Rikujtojmë se sipas nenit 6, paragrafi 1 i Ligjit kundër Shpifjes dhe Fyerjes, barra e provës i takon Paditësit, dhe jo të Paditurës për vërtetimin e përgjegjësisë për shpifje për deklarata që kanë të bëjnë me çështje të interesit publik. Me padinë për shpifje dhe dokumentet e bashkëngjitura në

---

<sup>11</sup> *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GjEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 83, 84 dhe referencat në të.

<sup>12</sup> *Axel Springer AG kundër Gjermanisë*, Nr. 39954/08, GjEDNJ, 7 shkurt 2012, paragrafi 109 dhe referencat në të.

<sup>13</sup> *GRA Stiftung gegen Rassismus und Antisemitismus kundër Zvicrës*, Nr. 18597/13, GjEDNJ, 9 janar 2018, paragrafet 77, 78.



padi nuk është vërtetuar se e Paditura ka shpifur. Prandaj, me anë të kësaj përgjigje në padi kërkojmë nga gjykata që pas shqyrtimit të padisë të nxjerrë këtë:

#### AKTGJYKIM

- I. REFUZOHET si plotësisht e pabazuar Padia për shpifje e Paditësit, Kelkos Energy Sh.P.K. kundër të Paditurës Shpresa Loshaj e parashtruar më datë 1 qershor 2020.
- II. DETYROHET Paditësi KELKOS Energy Sh.P.K. t'i që t'ia kompensojë të Paditurës Shpresa Loshaj, shpenzimet e avokates dhe shpenzimet procedurale.

---

Rina Kika  
Avokate  
049 355 722  
[rina@kika-associates.com](mailto:rina@kika-associates.com)

## Lista e provave dhe e shtojcave

**Prova nr.1.1:** Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport nga monitorimi i ndërmarrjes «Kelkos Energy» Sh.p.k.*, 14 dhjetor 2016, faqe 17-18.

**Prova nr.1.2:** Zyra e Rregullatorit për Energji, *Raport vjetor 2018*, mars 2019, faqe 18.

**Prova nr. 2.1:** Hidrodrini, *Njoftim*, 24 dhjetor 2013

**Prova nr. 2.1:** Hidrodrini, *Njoftim*, 28 prill 2014

**Prova nr.3:** Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit, Departamenti i Ujërave, *Inspektim në bazë të ankesës së Hidrodrinit rreth ndërtimin e HEC- ve, Deçan*, 5 maj 2014.

**Prova nr. 4:** Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Hydrocentralet në Parqet Kombëtare, rrezik për biodiversitetin*, 25 shkurt 2019.

**Prova nr. 5:** Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, *Raportin për Gjendjen e Natyrës për vitet 2015-2017*, publikuar në vitin 2019.

### Prova nr.6:

- Foto nga Pishtarët dhe burime tjera
- Kallxo.com, [Vuajtja e Grykës së Deçanit nga hidrocentralet](#), 13 shtator 2018.
- Koha.net, [Katër hidrocentrale si ato që po synohen në Lumbardh kanë shkatërruar Grykën e Deçanit](#), 25 shkurt 2019.
- RTV21.tv, Protestuesit ‘pushtojnë’ grykën e Deçanit kundër hidrocentraleve pa leje, 13 korrik 2019
- Klan Kosova TV, [Hydrocentrali në Deçan thanë Zonën](#), 10 prill 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=8o3kRXhZ7Ck&feature=youtu.be>
- Koha.net, *Ramosaj thotë se kompania austriake bëri shumë shkelje kur nisi ndërtimin e hidrocentraleve në Lumbardh*, 10 mars 2019.

**Prova nr.7:** INDEP, Balkan Green Foundation, *Hydrocentralet në Kosovë – Problemet dhe potenciali i tyre real*, mars 2019, faqet 1-3, 18-20 dhe 24.

**Prova nr.8:** Korrespondenca në mes të Shpresa Loshajt, gazetares Jeta Xharra dhe Kastriot Berishës, Zyrtar ligjor nga Departamenti ligjor i BIRN.